

LIGJ
Nr. 10/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS
DHE HERCEGOVINËS, QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË,
QEVERISË SË MALIT TË ZI, QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR NGRITJEN E TASK-FORCËS
MJEKËSORE TË BALLKANIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Qeverisë së Malit të Zi, Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për ngritjen e Task-Forcës Mjekësore të Ballkanit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.3.2018

Shpallur me dekretin nr. 10740, datë 12.3.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS, QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, QEVERISË SË MALIT TË ZI, QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SERBISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLOVENISË, MBI
NGRITJEN E TASK-FORCËS MJEKËSORE TË BALLKANIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe Hercegovinës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Malit të Zi, Qeveria e Republikës së Serbisë dhe Qeveria e Republikës së Sllovenisë, më poshtë të referuara si “Palët”,

duke identifikuar kapacitetet rajonale operationale mjekësore dhe duke njohur nevojën për përdorim të përmirësuar të kapaciteteve mjekësore ushtarake ekzistuese në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe duke vërejtur se duke qenë pjesë e një iniciative bashkëpunimi shumëkombëshe, shteteve u jepet mundësia të përdorin asetet e tyre mjekësore me më shumë efikasitet, pa mbivendosje dhe pa humbur efektivitetin;

duke iu referuar qëllimit të zhvillimit të një koncepti që është miratuar nga nënshkrimi i Deklaratës së Qëllimit të Grupit të Vlerësimit të Task-Forcës Mjekësore të Ballkanit, të datës 2014,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

1. “Task-Forca Mjekësore e Ballkanit (BMTF)”, Njësia Ushtarake Mjekësore Shumëkombëshe e përbërë nga modulet mjekësore, të formuara nga kontributet e Palëve.

2. “Shtet Kuadër (FN)”, një palë që ofron, mbi bazë rotacioni, infrastrukturën, personelin dhe pajisjet bazë të nevojshme për kapacitetin e ROLE 2, përveç detyrimit të saj si Palë, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje dhe në marrëveshjet zbatuese.

3. “Sponsor”, çdo shtet, organizatë ose subjekt, i ndryshëm nga pjesëmarrësit në BMTF, që ofron mbështetje financiare dhe/ose mbështetje tjetër për BMTF-në, siç përcaktohet në marrëveshjen përkatëse.

4. “Shtet pritës (HN)”, Republika e Maqedonisë që ofron vendosjen e Strukturës Organizative të Përhershme të BMTF-së.

5. “Organizata e Përhershme e BMTF-së”, organ i përhershëm në kohë paqeje i BMTF-së, përgjegjëse për organizimin dhe planifikimin e aktiviteteve të trajnimit dhe operationeve në kohë paqeje dhe/ose operationeve të paparashikuara të BMTF-së.

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është rregullimi i procedurave dhe përgjegjësi ndërmjet Palëve për ngritjen dhe funksionimin e BMTF-së.

Neni 3

Misioni i BMTF-së

1. Me qëllim identifikimin, përmirësimin dhe lehtësimin e kapaciteteve operationale mjekësore të rajonit të Ballkanit Perëndimor, qëllimi i BMTF-së është vënia në dispozicion e mbështetjes mjekësore në nivelin e ROLE 2 në operationet në përgjigje të krizave (CRO), në një mënyrë të qëndrueshme dhe për t’iu përgjigjur brenda një kohe të shpejtë një spektri të gjerë të situatave të ndihmës në raste të fatkeqësive rajonale. Qëllimi është mundësimi i shteteve pjesëmarrëse që të ofrojnë kapacitete kryesore

në operacionet ndërkombëtare, të përmirësojnë kapacitetet e shërbimeve mjekësore kombëtare dhe të arrijnë qëllimet kombëtare të forcës/partneritetit të NATO-s dhe Partneritetit për Paqe (PfP) (objektivat e kapaciteteve).

2. Me qëllim përmbushjen e qëllimeve të lartpërmendura, BMTF-ja do të jetë e aftë:

- a) Të planifikojë, të zhvillojë dhe të marrë pjesë në aktivitetet shumëkombëshe të trajnimit, që synojnë arritjen dhe ruajtjen e gatishmërisë, kapaciteteve dhe efektivitetit të duhur operacional, si dhe të kontribuojë në përmirësimin e ndërveprueshmërisë;
- b) Të marrë pjesë në misionet e mandatuara nga OKB-ja brenda fushës së miratuar të përgjegjësisë;
- c) Të zhvillojë aktivitete të tjera të rena dakord bashkërisht nga Palët.

Neni 4

Aktivizimi i BMTF-së

1. BMTF-ja vihet në dispozicion për aktivizim të mundshëm:

- a) Me kërkesë të një ose më shumë palëve; ose
- b) Me kërkesë të organizatës ndërkombëtare përkatëse; ose
- c) Me kërkesë të një shteti tjetër.

2. Me pëlqimin paraprak të autoriteteve kombëtare të secilës Palë, aktivizimi i BMTF-së i nënshtrohet vendimmarrjes së SB-së.

Neni 5

Struktura, marrëdhëniet e komandimit dhe vendimmarrja në BMTF

1. BMTF-ja do të funksionojë në kohë paqeje dhe në kriza, siç përcaktohet hollësisht në këtë nen.

2. BMTF-ja do të jetë një njësi mjekësore shumëkombëshe, si një kapacitet ushtarak modular i dislokueshëm, i krijuar në bazë të kapaciteteve mjekësore kombëtare ekzistuese.

3. Organizata e Përhershme e BMTF-së (BMTF SO) është një organ i përhershëm në kohë paqeje i BMTF-së, përgjegjëse për organizimin dhe planifikimin e aktiviteteve të trajnimit, si dhe operacioneve në kohë paqeje dhe/ose operacioneve të paparashikuara të BMTF-së. Ajo është gjithashtu përgjegjëse për përgatitjen, trajnimin dhe certifikimin e njësisë.

4. Bordi Drejtues (SB) është organi më i lartë vendimmarrës, që përbëhet nga përfaqësuesit e autorizuar politikë dhe ushtarakë nga secila palë. SB-ja i merr vendimet me unanimitet.

5. Struktura e detajuar dhe marrëdhëniet e komandimit të BMTF-së do të përcaktohen në Memorandumin e Mirëkuptimit ose në dokumente të tjera përkatëse që do të nënshkruhen nga autoritetet përkatëse të Palëve.

6. Struktura organizative e BMTF-së së aktivizuar hyn në fuqi në kohë krize dhe do të përcaktohet në Memorandumin e Mirëkuptimit ose në dokumente të tjera përkatëse që do të nënshkruhen nga autoritetet përkatëse të Palëve.

Neni 6

Gjuhët zyrtare dhe të punës

Gjuhët zyrtare të BMTF-së janë gjuhët kombëtare të Palëve. Gjuha angleze do të jetë gjuha e punës dhe të gjitha dokumentet operationale duhet të lëshohen në këtë gjuhë.

Neni 7

Aspektet financiare

1. Kostot në lidhje me ngritjen, administrimin dhe funksionimin e BMTF-së financohen nga Palët dhe/ose sponsorët.

2. Shpenzimet e përbashkëta për BMTF SO-në do të mbulohen nga buxheti shumëkombësh i financuar

nga Palët, në përputhje me formulën për ndarjen e shpenzimeve, që do të përcaktohet në Memorandumin e Mirëkuptimit.

3. Pajisjet e blera nga fondet e përbashkëta dhe pajisjet e dhëna nga sponsorët do të jenë pronë e BMTF-së. Titulli i pronësisë i pajisjeve kombëtare të dhëna nga HN-ja i mbetet HN-së.

4. Parimet e hollësishme dhe metodat e financimit të BMTF-së do të përcaktohen në Memorandumin e Mirëkuptimit.

Neni 8

Shteti pritës dhe mbështetja e shtetit kuadër

1. HN-ja do të ofrojë mbështetjen logjistike për BMTF SO-në, siç përcaktohet në Memorandumin e Mirëkuptimit.

2. Një prej Palëve, mbi baza rotacioni, merr rolin e Shtetit Kuadër (FN). Si e tillë, përveç detyrimit të saj si Palë, ajo ofron infrastrukturën, personelin dhe pajisjet bazë të nevojshme për kapacitetin e ROLE 2. Detyrimet e hollësishme të një FN-je do të rregullohen në Memorandumin e Mirëkuptimit.

Neni 9

Konsideratat juridike

Dispozitat e “Marrëveshjes ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantikut Verior në lidhje me statusin e forcave të tyre” (NATO SOFA, e datës 19 qershor 1951), Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera që marrin pjesë në partneritetin për paqe, në lidhje me statusin e forcave të tyre (PfP SOFA, e datës 19 qershor 1995) dhe Konventës së OKB-së mbi privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara (e datës 13 shkurt 1946), rregullojnë statusin e personelit të BMTF-së, sipas rastit.

Neni 10

Pranimi në BMTF dhe pjesëmarrja në aktivitetet e BMTF-së

1. Çdo shtet mund të pranohet në këtë Marrëveshje me marrjen e pëlqimit paraprak me shkrim të të gjitha Palëve dhe nënshkrimin e një note pranimi në këtë Marrëveshje.

2. Çdo organizatë ndërkombëtare, subjekt ose çdo shtet/forcë e shtetit mund të marrë pjesë në aktivitetet e trajtimit ose operacionet e BMTF-së me pëlqimin paraprak të të gjitha Palëve dhe pas nënshkrimit të një marrëveshjeje përkatëse.

Neni 11

Klauzolat e sigurisë

1. I gjithë informacioni i shkëmbyer ose i gjeneruar në lidhje me këtë Marrëveshje përdoret, transmetohet, ruhet, trajtohet dhe/ose sigurohet në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare të zbatueshme të Palëve.

2. Informacioni transferohet vetëm nëpërmjet kanaleve të lejuara.

3. Palët garantojnë që i gjithë shkëmbimi i informacionit të përdoret vetëm për qëllimet e caktuara brenda objektivave dhe fushës së veprimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet vetëm me konsensus të përbashkët ndërmjet Palëve dhe nuk i referohet për zgjidhje asnjë gjykatë kombëtare ose ndërkombëtare ose Pale të Tretë.

Neni 13
Marrëveshjet zbatuese

Çështjet e hollësishme në lidhje me BMTF-në përcaktohen në një memorandum të veçantë mirëkuptimi ose në dokumente të tjera përkatëse të nënshkruara nga autoritetet përkatëse të Palëve.

Neni 14
Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore.
 2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e 30-të pas njoftimit të fundit nga Palët drejtuar HN-së që janë përfunduar të gjitha procedurat e brendshme për hyrjen e saj në fuqi.
 3. Kjo Marrëveshje ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve. Ndryshimi propozohet me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe hyn në fuqi në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.
 4. Kjo Marrëveshje përfundon me pëlqim unanim të Palëve në çdo kohë. Çdo Palë mund të tërhiqet nga Marrëveshja pas një njoftimi me shkrim me afat gjashtëmuor (6-mujor) drejtuar HN-së, i cili njofton Palët e tjera në rrugë diplomatike.
 5. Nëse kjo Marrëveshje përfundon ose në qoftë se një prej Palëve tërhiqet nga Marrëveshja, Palët do të zgjidhin të gjitha çështjet e mbetura, si dhe fusha të mundshme të interesit në lidhje me përfundimin ose tërheqjen nga Marrëveshja.
 6. Prishja e Marrëveshjes shfuqizon të gjitha marrëveshjet/memorandumet zbatuese të mirëkuptimit.
 7. Shteti pritës do të jetë depozitari i kësaj Marrëveshjeje.
- Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e poshtëshënuar, të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Nënshkruar në gjashtë (6) kopje origjinale në gjuhën angleze.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë: _____

Nënshkruar në, më

Për Këshillin e Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës: _____

Nënshkruar në, më

Për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë:

Nënshkruar në, më

Për Qeverinë e Malit të Zi:

Nënshkruar në, më

Për Qeverinë e Republikës së Serbisë:

Nënshkruar në, më

Për Qeverinë e Republikës së Sllovenisë:

Nënshkruar në, më